- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.

**2.3.9** OE duhet të paraqesin në Ofertë e tyre edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a- Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (specifikimet teknike, metodologjia e punës, grafikun e shërbimeve).

b- Operatori ekonomik duhet që të paraqese një deklaratë nepermjet se ciles merr persiper te garantoje qe nese shpallet fitues qe depozitimi i mbetjeve do te behet ne landfill. Deklarata duhet te shoqerohet me nje kontrate ose marreveshje me landfillim per depozitimn e mbetjeve.

c- Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklaratë me shkrim nga administratori i shoqerise qe brenda tre muajve nga lidhja e kontrates do te gjeje nje vend parkimi te makinerive per kryerjen e shërbimit.

**2.3.10** Operatori Ekonomik ofertues ne me shume se nje Lot, duhet te kete kapacitetet ekonomike - financiare si dhe kapacitet teknike, sa shuma e loteve per te cilat ka ofertuar te marra se bashku. Ne kete rast, operatori ekonomik ofertues ne me shume se nje lot duhet te paraqese nje deklaratë ku te listohen dokumentat e paraqitura ne permbushje te kritereve komulative per Lotet konkret. Ne rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorezuar ne permbushje te kritereve komulative nuk ploteson kapacitet ekonomike-financiare dhe kapacitetet teknike per te gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do te skualifikohet ne te gjitha Lotet ku ka ofertuar.

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

## **Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

#### **LOTI I-re, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 1, BASHKIA LEZHE”.**

#### **Kuptimi i termave**

Termat e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, në Termat e Referencës si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe ligjin nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik” etj.

#### **Qëllimi i Specifikimeve Teknike**


Këto Specifikime teknike synojnë që të saktësojnë kërkesat e Bashkisë Lezhë në vijim Autoritetit Kontraktues, në lidhje me qëllimi e Kontratës për Grumbullimim , Transortin dhe Trajtimin i Mbetjeve Urbane në territorin e Zonës I të shërbimit (sic specifikohet më poshtë), në sasinë dhe cilësinë dhe shpërndarjen e këtij shërbimi të përcaktuara në Termat e Referencës dhe në hartat bashkëlidhur.

#### **Skicimet, parametrat teknik etj:**

**Zona e I-rë** mbulon Njësitë Administrative:

Shërbimi mbulon territorin e Zonës së I-rë të Bashkisë Lezhë (harta në vijim). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës I - rë të shërbimit është vlerësuar rreth 29,489 banorë (e llogaritur për vitin 2020) në periudhën Tetor – Prill, e cila shtohet me rreth 35,000 persona për çdo ditë në sezonin turistik Maj – Shtator, veçanërisht në zonën e Shëngjinit. Numri i popullsisë që do të marrin shërbim në këtë Zonë në vitin 2021 është vlerësuar ne rreth 29 489 banorë rezidentë (pa përfshirë këtu popullsinë vizitore (turistët). Ndërsa llogaritja për periudhën e sezonit turistik është bërë më vete, duke llogaritur kohë shërbimi prej 5 muaj (150 ditë)

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njësiave Administrative ku shtrihet shërbimi.



**Figure 1: Ndarja zonale e Bashkise Lezhe**

Sic shikohet në hartën në Figurën 1 më sipër, Zona I subjekt i kësaj kontrate (me ngjyrë blu) mbulon Njësitë Administrative Lezhë dhe Shëngjin dhe një pjesë të Njësisë Administrative Kolsh.

### Mjetet e shërbimit

#### Kontenierët

Shërbimi do të realizohet më kontenierë metalike të cilat duhet të plotësojnë parametrat si më poshtë:

Kapacitet : 1.1 m<sup>3</sup>

- -Vellimi 1.1 m<sup>3</sup>
- -Kapaciteti i plote 1100 litra
- -Pesha 100 kg
- -Materiali i trupit te kontenerit llamarine e paster d= 1.5 – 1.8 mm
- -Mbeshtetsja e kontenjerit me spesor 1.8 -2 mm e lart.
- - Materiali i baza e mbeshtetjes se rrotes te jete 4.5 mm .
- -Lloji i celikut C, 0361 dhe C, 0146 ose me kualitativ
- -Numri i dorezave per ngritje Dy anesore majtas dhe djathtas
- -Materiali i kapakut te kontinerit llamarine e pastruar d= 1.5 m
- Mekanizmi per pershtatjen.
- -Numri i dorezave per hapjen e kapakut dy anash majtas e djathtas
- -Numri i rrotave 4 cope.



- -Dimensionet e rrotave fi ø 200 mm me gome mishi.
- -Aksi i rrotave me kushineta.
- -Levzshmeria e rrotave 360 grade.
- -Fuqia e mbajtjes se peshes se rrotave 800 kg
- -Sistemi i rrotave
- me mekanizem frenimi te dy rrotave te para.
- -Kualiteti i mbrojtjes 99.99% heqja e ndryshkut.
- -Lyerja me boje 100% e kapakut.
- -Zinkimi i kontinierit 100% e trupit me te gjitha

### **Automjetet**

Operatori do të vendosë në dispozicion të zbatimit të kësaj kontrate mjetet si më poshtë janë specifikuar:

#### ***Kamion teknologjik me kapacitet 10 / 15 ton për mbetjet***

**Kapaciteti:** Një kamion teknologjik me kapacitet 10 – 15 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor me ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme ansore që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjatw procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim - shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane;

**Koeficienti i ngjeshjes:** Kamioni duhet të jetë i pajisur me mekanizëm ngjeshës (1:4 - 1:6);

**Kapaciteti i mbushjes:** minimumi 85 %

**Mekanizmi i ngarkimit:** Mekanizme hidraulik ose mekanik fundor ose anesor për kontenierë 1,100 L që do të përdoren në termat e kësaj kontrate që adaptohet edhe për kontenierë me te vegjel (240 L nëse do të kërkohët në raste të vecanta);

Sistemi i ngarkimit duhet të jetë plotësisht funksional dhe do të lejojë një cikël (ngritja e kontenierëve, shkarkimi dhe ulja në vend e një kontenieri plot ( peshë minimale 250 kg) në një afat kohor prej 20 – 30 sekondash .

**Koha e ngarkimi – shkarkimit të kontenierit:** maksimumi 20 - 30 sek.

**Kushte të përgjithshme:** Kamionët duhet të jenë në gjendje të mirë pune, pa rrjedhje të ndonjë likuidi, në mënyrë që të jenë në gjendje të punojnë 16 orë në ditë (me dy turne) në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike, dhe të sigurojnë një shpejtësi maksimale lëvizje deri në 80 km/orë.

Kamionët duhet të jenë të pajisur në anën e pasme në të dy anët, me këmbalkë dhe doreza mbajtëse për punëtorët, sistem komunikimi (radio ose telefon) që të lidhen me qendrën e operimit ose dispecerinë e Operatorit.

Operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionëve, që ata të punojnë në mënyrë të plotë dhe në çdo kohë me efektivitetin e kërkuar.

Operatori është përgjegjës për regjistrimin, pagesën e të gjitha taksave, kolaudimin teknik, mbajtjen e kamionëve të pastër dhe të larë të paktën njëherë në dy ditë. Targa, emri, adresa dhe kontaktet e Operatorit duhet të jenë të dukshme në çdo kamion, të shkruara dhe të shtypura me germa të mëdha, jo më të vogla se 10 cm.

Në të dy faqet anësore të kamionit do të vendosen postera vetngjitës (adezivw) me përmasa dhe përmbajtje që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.

***Kamion vetshkarkues me kapacitet 6- 10 ton për transportin e kontenierëve:***

**Kapaciteti:** Deri 6-10 ton, i pajisur vinc dhe me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtme që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti e shkarkimi i kontenierëve për larje;

**Lartësia e spondeve:** Deri 80 mm

Kamioni do të ketë një **vinc të montuar** në pjesën ndërmjet kabinës dhe karrocërisë, kapacitet ngritës deri në 2 ton, i cili do të përdoret kryesisht për ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve por edhe të mbetjeve voluminoze kur të jetë e nevojshme; spond ansor ose fundor te hapshem për të lejuar ngarkimin e kontenierëve si dhe mbulose kur përdoret për grumbullimin e mbetjeve të vëllimshme.

**Kushte të përgjithshme:** Janë të njëjta si dhe për kamionin teknologjik për mbetjet e pariciklueshme.

**Automjete rezervë**

Operatori do të vëre në dispozicion të zbatimit të kësaj kontratë edhe mjete të tjera ta cilat do të kërkohet të përdoren në kushte të vecanta për shkak të aksesit të vështirë rrugor, gjenerimit të mbetjeve mbi normën e llogaritur si dhe rritjen e volumit të mbetjeve vecanërisht për efekt të rritjes së pritshme të rritjes së numrit të turistëve, duke filluar nga viti i dytë i kontratës, vecanërisht në Njësinë Administrative të Shëngjinit.

Këto mjete do të jenë me përdorim të përkohshëm ( të llogaritura sa ¼ e kohës së plotë të përdorimit), dhe do të përfshijnë:

***Kamioncinë me kapacitet 1-3 ton:***

**Kapaciteti:** Deri 1-3 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve në kushte të vecanta me akses të vështirë rrugor.

***Mjet germimi – ngarkim (fadromë me goma)***

Operatori do të ketë në dispozicion një mjet për germim dhe ngarkim (fadrome me goma) e cila do të përdoret sipas rasteve dhe kur të jetë e nevojshme me porosi apo kërkesë të vecantë të Autoritetit Kontraktues ose me propozim të Operatorit.

**Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve**

Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo ditë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje ose do e kryejë procesin e larjes dhe dezinfektimit në PGM me mjetet dhe pajisjet specifike. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.

Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë, të paktën sa 5 % e numrit të kontenierëve në përdorim për të zëvendësuar çdo ditë kontenierët e tërhequr për tu larë.

Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.

Rekomandohet që të përdoret një sasi sa me e vogël uji dhe solucioni larës.

Ujrat nga larja e kontenierëve duhet të derdhen në sistemin e ujrave të zeza ose në një depozitë e cila siguron trajtimin e tyre paraprakisht derdhjes në natyrë.

Me elementin e dezinfektimit kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane etj.

Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij një depozitë uji si dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve ose të kryejë procesin në PGM me mjetet dhe paisjet specifike.

Dezinfektimi dhe deratizimi kryhet me dezinfektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit për mirëmbajtjen e kontenierëve duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **Grafiku i larjes së kontenierëve**

Grafiku për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatitet nga Operatori i Shërbimit dhe miratohet çdo vit nga Autoriteti kontratues.

Grafiku i këtij aktiviteti perputhet me grafikun e grumbullimit të mbetjeve duhet të zbatohet rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.

Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre

### **Rregulla për tu zbatuar**

Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj.

Të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit e të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore (Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe) dhe më pas nga Autoriteti Kontratues.

Mos miratimi i lëndëve kimike dhe normës së përdorimit të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

### **Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, Pastrimi dhe Mirëmbajtja**

Operatori i shërbimit do të mbajë të pastër (pastrojë dhe fshijë me fshesë dore) Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, nga të gjitha mbetjet e cilat ndodhen jashtë kontenerëve ose që bien nga kontenerët gjatë procesit të ngarkimit të mbetjeve në mjet. Pastrimi do të bëhet mbi një sipërfaqen jo më të vogël se **30 m<sup>2</sup>**. PGM do të desnifektohet periodikisht me një përzjerje pluhur gëlqere me 5 % klor.

Pastrimi dhe fshirja e PMG-ve do të përmbledhë mbledhjen, pastrimin dhe largimin e mbeturinave të hedhura në dhe përreth PGM-ve dhe pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes së caktuar brenda dhe rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenerëve dhe sistemimi në vëndet e caktuara.

Kontenerët do të vendosen në rrafsh horizontal, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.

Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, Operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Penalitetet dhe Ndalesat”.

Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur larg PGM –ve të miratuara, Operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen e pikave të reja në grafikun e punimeve.

Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e mjeteve dhe punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë nga dhe me koston e Operatorit. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë, Operatori do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

Përdorimi i uniformave dhe i kartave të identifikimit për punonjësit që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

### **Informimi dhe komunikimi**

Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë Komunikimi” për marrjen e ankesave apo kërkesave, e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 10.00-18.00. Përfaqësues të Operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit Kontratus dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 48 oreve nga marrja e njoftimit. Operatori duhet të vërë në dispozicion një numër telefoni, i cili do të bëhet publik dhe do të vendoset në Zyren e Komunikimi për t’i krijuar mundësi komunikimi qytetarëve dhe institucioneve.

Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kontratus në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, përfshi këtu familjarë, biznese

apo institucione, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin Kontratus.

### **Vendi i depozitimit të mbetjeve**

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit.

Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazen e cimin njësi aktual të depozitimit në landfill-in e Bushatit dhe sasisë së mbetjeve të vleresuara nga Autoriteti Kontraktues.

### **Personeli Kryesor**

Përveç sa është specifikuar në Shtojcën përkatëse për kërkesat e personelit, të dhëna të tjera specifike janë paraqitur sa më poshtë:

#### **Drejtuesi teknik (DT)**

DT duhet të ketë arsim të lartë, i diplomuar në një nga fushat sipas kuadrit ligjor në fuqi që rregullon veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit dhe sic është specifikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

#### **Përgjegjesi teknik (PT)**

PT duhet të ketë minimumi arsim të mesëm të pergjithshem ose profesional ne fushat teknike. Avantazh do të jetë arsimi i larte.

#### **Punojësit e tjere**

Shoferët/drejtuesit e mjeteve duhet të jenë të pajisur me patentë sipas përcaktimeve të kodit Rrugor referuar mjetit që drejton;

Shoferët/drejtuesit e mjeteve, duhe të kenë një eksperience pune me mjete të ngjashme ose të të njëjtit kapacitet .

#### **Rritja e kapaciteteve të personelit**

Operatori do te punoje dhe trajnoje personelin e kualifikuar dhe ate punetor periodikishit per rritjen e kapaciteteve mbi rendesine e mbjajtjes paster te mjedisit, ndarjen e mbetjeve ne burim, grumbullimin e diferencuar, reduktimin e mbetjeve, sigurine ne pune, mirembajtjen e mjeteve dhe paisjeve, kryrerjen e proceseve te punes me cilesi dhe korrektese dhe tema te tjera qe lidhen me objekin e kesaj kontrate.

## **LOTI II-te, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 2, BASHKIA LEZHE”.**

### **Kuptimi i termave**

Termtat e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termtat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, në Termtat e Referencës si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe ligjin nr. 162/2020 , “Për Prokurimin Publik” etj.

### **Qëllimi i Specifikimeve Teknike**

Këto Specifikime teknike synojnë që të saktësojnë kërkesat e Bashkisë Lezhë në vijim Autoritetit Kontraktues, në lidhje me qëllimi e Kontratës për Grumbullimim , Transortin dhe Trajtimin i Mbetjeve Urbane në territorin e Zonës II të shërbimit (sic specifikohet më poshtë), në sasinë dhe cilësinë dhe shpërndarjen e këtij shërbimi të përcaktuara në Termtat e Referencës dhe në hartat bashkëlidhur.

### **Skicimet, parametrat teknik etj:**


**Zona II** mbulon Njësitë Administrative:

1. Shënkoll;
2. Zejmen;
3. Kolsh;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njërive Administrative ku shtrihet shërbimi.

Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës II të Bashkisë Lezhë (figura. 6). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës II të shërbimit e llogaritur rreth 22,645 banorë (e llogaritur për vitin 2020). Norma e gjenerimit për këtë njësi është llogaritur 0.5 kg/banor/ditë, për shkak se zona ka një zonë të theksuar industriale përgjatë superstradës SH1/E762, si dhe një frekuentim të lartë të plazhit në zonën e Tales gjatë sezonit të verës.

Kufijtë e Zonës së II-të të shërbimit, dhe itineraret e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve janë dhënë saktësisht në hartat bashkangjitur dokumentit të Termave të Referencës



**Figure 2: Ndarja zonale e Bashkise Lezhe**

Sic shikohet në hartën në Figurën 1 më sipër, Zona II subjekt i kësaj kontrate (me ngjyrë Viola) mbulon Njësitë Administrative Shenkoll, Zejmen dhe Kolsh .

## Mjetet e shërbimit

### Kontenierët

Shërbimi do të realizohet më kontenierë metalike të cilat duhet të plotësojnë parametrat si më poshtë:

Kapacitet : 1.1 m<sup>3</sup>

- -Vellimi 1.1 m<sup>3</sup>
- -Kapaciteti i plote 1100 litra
- -Pesha 100 kg
- -Materiali i trupit te kontinerit llmarine e paster d= 1.5 – 1.8 mm
- -Mbeshtetsja e kontenjerit me spesor 1.8 -2 mm e lart.
- - Materiali i baza e mbeshtetjes se rrotes te jete 4.5 mm .
- -Lloji i celikut C, 0361 dhe C, 0146 ose me kualitativ
- -Numri i dorezave per ngritje Dy anesore majtas dhe djathtas
- -Materiali i kapakut te kontinerit llmarine e pastruar d= 1.5 m
- Mekanizmi per pershtatjen.
- -Numri i dorezave per hapjen e kapakut dy anash majtas e djathtas
- -Numri i rrotave 4 cope.

- -Dimensionet e rrotave fi ø 200 mm me gome mishi.
- -Aksi i rrotave me kushineta.
- -Levzshmeria e rrotave 360 grade.
- -Fuqia e mbajtjes se peshes se rrotave 800 kg
- -Sistemi i rrotave me mekanizem frenimi te dy rrotave te para.
- -Kualiteti i mbrojtjes 99.99% heqja e ndryshkut.
- -Lyerja me boje 100% e kapakut.
- -Zinkimi i kontinierit 100% e trupit me te gjitha

### **Automjetet**

Operatori do të vendosë në dispozicion të zbatimit të kësaj kontrate mjetet si më poshtë janë specifikuar:

#### ***Kamion teknologjik me kapacitet 10 ton për mbetjet***

**Kapaciteti:** Një kamion teknologjik me kapacitet 10 – 15 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor me ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme ansore që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjatw procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim - shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane;

**Koeficienti i ngjeshjes:** Kamioni duhet të jetë i pajisur me mekanizëm ngjeshës (1:4 - 1:6);

**Kapaciteti i mbushjes:** minimumi 85 %

**Mekanizmi i ngarkimit:** Mekanizme hidraulik ose mekanik fundor ose anesor për kontenierë 1,100 L që do të përdoren në termat e kësaj kontrate që adaptohet edhe për kontenierë me te vegjel (240 L nëse do të kërkohët në raste të vecanta);

Sistemi i ngarkimit duhet të jetë plotësisht funksional dhe do të lejojë një cikël (ngritja e kontenierëve, shkarkimi dhe ulja në vend e një kontenieri plot ( peshë minimale 250 kg) në një afat kohor prej 20 – 30 sekondash .

**Koha e ngarkimi – shkarkimit të kontenierit:** maksimumi 20 - 30 sek.

**Kushte të përgjithshme:** Kamionët duhet të jenë në gjendje të mirë pune, pa rrjedhje të ndonjë likuidi, në mënyrë që të jenë në gjendje të punojnë 16 orë në ditë (me dy turne) në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike, dhe të sigurojnë një shpejtësi maksimale lëvizje deri në 80 km/orë.

Kamionët duhet të jenë të pajisur në anën e pasme në të dy anët, me këmbalkë dhe doreza mbajtëse për punëtorët, sistem komunikimi (radio ose telefon) që të lidhen me qendrën e operimit ose dispecerinë e Operatorit.

Operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionëve, që ata të punojnë në mënyrë të plotë dhe në çdo kohë me efektivitetin e kërkuar.

Operatori është përgjegjës për regjistrimin, pagesën e të gjitha taksave, kolaudimin teknik, mbajtjen e kamionëve të pastër dhe të larë të paktën njëherë në dy ditë. Targa, emri, adresa dhe kontaktet e Operatorit duhet të jenë të dukshme në çdo kamion, të shkruara dhe të shtypura me germa të mëdha, jo më të vogla se 10 cm.



Në të dy faqet anësore të kamionit do të vendosen postera vetngjitës (adezivw) me përmasa dhe përmbajtje që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.

***Kamion vetshkarkues me kapacitet 6- 10 ton për transportin e kontenierëve:***

**Kapaciteti:** Deri 6-10 ton, i pajisur vinc dhe me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvizjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti e shkarkimi i kontenierëve për larje;

**Lartësia e spondeve:** Deri 80 mm

Kamioni do të ketë një **vinc të montuar** në pjesën ndërmjet kabinës dhe karrocërisë, kapacitet ngritës deri në 2 ton, i cili do të përdoret kryesisht për ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve por edhe të mbetjeve voluminoze kur të jetë e nevojshme; spond anësor ose fundor të hapshëm për të lejuar ngarkimin e kontenierëve si dhe mbulës kur përdoret për grumbullimin e mbetjeve të vëllimshme.

**Kushte të përgjithshme:** Janë të njëjta si dhe për kamionin teknologjik për mbetjet e pariciklueshme.

**Automjete rezervë**

Operatori do të vërehet në dispozicion të zbatimit të kësaj kontrate edhe mjete të tjera ta cilat do të kërkohet të përdoren në kushte të vecanta për shkak të aksesit të vështirë rrugor, gjenerimit të mbetjeve mbi normën e llogaritur si dhe rritjen e volumit të mbetjeve vëcanërisht për efekt të rritjes së pritshme të rritjes së numrit të turistëve, duke filluar nga viti i dytë i kontratës, vëcanërisht në Njësinë Administrative të Shëngjinit.

Këto mjete do të jenë me përdorim të përkohshëm ( të llogaritura sa ¼ e kohës së plotë të përdorimit), dhe do të përfshijnë:

***Kamioncinë me kapacitet 1-3 ton:***

**Kapaciteti:** Deri 1-3 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvizjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve në kushte të vecanta me akses të vështirë rrugor.

**Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve**

Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo ditë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje ose do e kryejë procesin e larjes dhe dezinfektimit në PGM me mjetet dhe pajisjet specifike. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.

Për të mundur kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë, të paktën sa 5 % e numrit të kontenierëve në përdorim për të zëvendësuar çdo ditë kontenierët e tërhequr për tu larë.

Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.

Rekomandohet që të përdoret një sasi sa më e vogël uji dhe solucioni larës.

Ujrat nga larja e kontenierëve duhet të derdhen në sistemin e ujrave të zeza ose në një depozitë e cila siguron trajtimin e tyre paraprakisht derdhjes në natyrë.

Me elementin e dezinfektimit kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane etj.

Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij një depozitë uji si dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve ose të kryeje procesin në PGM me mjetet dhe paisjet specifike.

Dezinfektimi dhe deratizimi kryhet me dezinfektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit për mirëmbajtjen e kontenierëve duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **Grafiku i larjes së kontenierëve**

Grafiku për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatitet nga Operatori i Shërbimit dhe miratohet çdo vit nga Autoriteti kontratues.

Grafiku i këtij aktiviteti perputhet me grafikun e grumbullimit të mbetjeve duhet të zbatohet rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.

Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre

### **Rregulla për tu zbatuar**

Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj.

Të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore (Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe) dhe më pas nga Autoriteti Kontratues.

Mos miratimi i lëndëve kimike dhe normës së përdorimit të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

### **Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, Pastrimi dhe Mirëmbajtja**

Operatori i shërbimit do të mbajë të pastër (pastrojë dhe fshijë me fshesë dore) Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, nga të gjitha mbetjet e cilat ndodhen jashtë kontenierëve ose që bien nga kontenierët gjatë procesit të ngarkimit të mbetjeve në mjet. Pastrimi do të bëhet mbi një sipërfaqe jo më të vogël se **30 m<sup>2</sup>**. PGM do të desnifektohet periodikisht me një përzierje pluhur gëlqere me 5 % klor.

Pastrimi dhe fshirja e PMG-ve do të përmbledhë mbledhjen, pastrimin dhe largimin e mbeturinave të hedhura në dhe përreth PGM-ve dhe pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes së caktuar brenda dhe rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve dhe sistemimi në vëndet e caktuara.

Kontenierët do të vendosen në rrafsh horizontal, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.

Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, Operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Penalitetet dhe Ndalesat”.

Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur larg PGM –ve të miratuara, Operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen e pikave të reja në grafikun e punimeve.

Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e mjeteve dhe punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë nga dhe me koston e Operatorit. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë, Operatori do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

Përdorimi i uniformave dhe i kartave të identifikimit për punonjësit që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

### **Informimi dhe komunikimi**

Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë Komunikimi” për marrjen e ankesave apo kërkesave, e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 10.00-18.00. Përfaqësues të Operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit Kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 48 oreve nga marrja e njoftimit. Operatori duhet të vërë në dispozicion një numër telefoni, i cili do të bëhet publik dhe do të vendoset në Zyren e Komunikimi për t’i krijuar mundësi komunikimi qytetarëve dhe institucioneve. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, përfshi këtu familjarë, biznese apo institucione, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin Kontratues.

### **Vendi i depozitimit të mbetjeve**

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit. Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazen e cimin njësi aktual të depozitimit në landfill-in e Bushatit dhe sasisë së mbetjeve të pariciklueshme të vleresuara nga Autoriteti Kontraktues.

### **Personeli Kryesor**

Përvec sa është specifikuar në Shtojcën përkatëse për kërkesat e personelit, të dhëna të tjera specifike janë paraqitur sa më poshtë:

### **Drejtuesi teknik (DT)**

DT duhet të ketë arsim të lartë, i diplomuar në një nga fushat sipas kuadrit ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë për mbrojtjen e mjedisit dhe sic është specifikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

### **Përgjegjësi teknik (PT)**

PT duhet të ketë minimumi arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional në fushat teknike. Avantazh do të jetë arsimi i lartë.

### **Punojësit e tjerë**

Shoferët/drejtuesit e mjeteve duhet të jenë të pajisur me patentë sipas përcaktimeve të kodit Rrugor referuar mjetit që drejton;  
Shoferët/drejtuesit e mjeteve, duhet të kenë një eksperiencë pune me mjete të ngjashme ose të të njëjtit kapacitet .

### **Rritja e kapaciteteve të personelit**

Operatori do të punojë dhe trajnojë personelin e kualifikuar dhe atë punëtor periodikisht për rritjen e kapaciteteve mbi rëndësinë e mbajtjes paster të mjedisit, ndarjen e mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar, reduktimin e mbetjeve, sigurinë në punë, mirëmbajtjen e mjeteve dhe paisjeve, kryerjen e proceseve të punës me cilësi dhe korrektësi dhe tema të tjera që lidhen me objektin e kësaj kontrate.

## **LOTI III-te, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 3, BASHKIA LEZHE”.**

### **Kuptimi i termave**

Termet e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, në Termat e Referencës si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe ligjin nr. 162/2020 , “Për Prokurimin Publik” etj.

### **Qëllimi i Specifikimeve Teknike**

Këto Specifikime teknike synojnë që të saktësojnë kërkesat e Bashkisë Lezhë në vijim Autoritetit Kontraktues, në lidhje me qëllimi e Kontratës për Grumbullimim , Transortin dhe Trajtimin i Mbetjeve Urbane në territorin e Zonës I të shërbimit (sic specifikohet më poshtë), në sasinë dhe cilësinë dhe shpërndarjen e këtij shërbimi të përcaktuara në Termat e Referencës dhe në hartat bashkëlidhur.

### **Skicimet, parametrat teknik etj:**


**Zona III** mbulon Njësitë Administrative:

1. Balldre;
2. Kallmet;
3. Ungrej;
4. Dajç;
5. Blinisht;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit për zonën e III-të përputhen me kufijtë administrativ të Njërive Administrative ku shtrihet shërbimi. Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës III të Bashkisë Lezhë (figura. 6). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës III të shërbimit e llogaritur rreth 23,590 banorë (e llogaritur për vitin 2020). Norma e gjenerimit e llogaritur për këtë zonë është 0.4 kg/banor/ditë.

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njërive Administrative ku shtrihet shërbimi.

Kufijtë e Zonës së III-të të shërbimit, dhe itineraret e grumbullimit të mbetjeve janë dhënë saktësisht në hartat bashkangjitur dokumentit të Termave të Referencës



**Figure 3: Ndarja zonale e Bashkise Lezhe**

Sic shikohet në hartën në Figurën 1 më sipër, Zona III subjekt i kësaj kontrate (me ngjyrë Gjelber) mbulon Njësitë Administrative .

Balldre;  
Kallmet;  
Ungrej;  
Dajç;  
Blinisht

### Mjetet e shërbimit

#### Kontenierët

Shërbimi do të realizohet më kontenierë metalike të cilat duhet të plotësojnë parametrat si më poshtë:

Kapacitet : 1.1 m<sup>3</sup>

- Vellimi 1.1 m<sup>3</sup>
- Kapaciteti i plote 1100 litra
- Pesha 100 kg
- Materiali i trupit te kontinerit llamarine e paster d= 1.5 – 1.8 mm
- Mbeshtetsja e kontenjerit me spesor 1.8 -2 mm e lart.
- Materiali i baza e mbeshtetjes se rrotes te jete 4.5 mm .
- Lloji i celikut C, 0361 dhe C, 0146 ose me kualitativ

- -Numri i dorezave per ngritje Dy anesore majtas dhe djathtas
- -Materiali i kapakut te kontinerit llamarine e pastruar d= 1.5 m
- Mekanizmi per pershtatjen.
- -Numri i dorezave per hapjen e kapakut dy anash majtas e djathtas
- -Numri i rrotave 4 cope.
- -Dimensionet e rrotave fi ø 200 mm me gome mishi.
- -Aksi i rrotave me kushineta.
- -Levzshmeria e rrotave 360 grade.
- -Fuqia e mbajtjes se peshes se rrotave 800 kg
- -Sistemi i rrotave
- me mekanizem frenimi te dy rrotave te para.
- -Kualiteti i mbrojtjes 99.99% heqja e ndryshkut.
- -Lyerja me boje 100% e kapakut.
- -Zinkimi i kontinierit 100% e trupit me te gjitha

### **Automjetet**

Operatori do të vendosë në dispozicion të zbatimit të kësaj kontrate mjetet si më poshtë janë specifikuar:

#### ***Kamion teknologjik me kapacitet 10 ton për mbetjet***

**Kapaciteti:** Një kamion teknologjik me kapacitet 10 – 15 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor me ndricues, si dhe pasqyra të jashtëme ansore që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjatw procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim - shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane;

**Koeficienti i ngjeshjes:** Kamioni duhet të jetë i pajisur me mekanizëm ngjeshës (1:4 - 1:6);

**Kapaciteti i mbushjes:** minimumi 85 %

**Mekanizmi i ngarkimit:** Mekanizme hidraulik ose mekanik fundor ose anesor për kontenierë 1,100 L që do të përdoren në termat e kësaj kontrate që adaptohet edhe për kontenierë me te vegjel (240 L nëse do të kërkohët në raste të vecanta);

Sistemi i ngarkimit duhet të jetë plotësisht funksional dhe do të lejojë një cikël (ngritja e kontenierëve, shkarkimi dhe ulja në vend e një kontenieri plot ( peshë minimale 250 kg) në një afat kohor prej 20 – 30 sekondash .

**Koha e ngarkimi – shkarkimit të kontenierit:** maksimumi 20 - 30 sek.

**Kushte të përgjithshme:** Kamionët duhet të jenë në gjendje të mirë pune, pa rrjedhje të ndonjë likuidi, në mënyrë që të jenë në gjendje të punojnë 16 orë në ditë (me dy turne) në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike, dhe të sigurojnë një shpejtësi maksimale lëvizje deri në 80 km/orë.

Kamionët duhet të jenë të pajisur në anën e pasme në të dy anët, me këmbalkë dhe doreza mbajtëse për punëtorët, sistem komunikimi (radio ose telefon) që të lidhen me qendrën e operimit ose dispecerinë e Operatorit.

Operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionëve, që ata të punojnë në mënyrë të plotë dhe në çdo kohë me efektivitetin e kërkuar.

Operatori është përgjegjës për regjistrimin, pagesën e të gjitha taksave, kolaudimin teknik, mbajtjen e kamionëve të pastër dhe të larë të paktën njëherë në dy ditë. Targa, emri, adresa dhe kontaktet e Operatorit duhet të jenë të dukshme në çdo kamion, të shkruara dhe të shtypura me germa të mëdha, jo më të vogla se 10 cm.

Në të dy faqet anësore të kamionit do të vendosen postera vetngjites (adezivw) me përmasa dhe përmbajtje që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.

#### ***Kamion vetshkarkues me kapacitet 6- 10 ton për transportin e kontenierëve:***

**Kapaciteti:** Deri 6-10 ton, i pajisur vinc dhe me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtëmë që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti e shkarkimi i kontenierëve për larje;

**Lartësia e spondeve:** Deri 80 mm

Kamioni do të ketë një **vinc të montuar** në pjesën ndërmjet kabinës dhe karrocërisë, kapacitet ngritës deri në 2 ton, i cili do të përdoret kryesisht për ngarkimin dhe shkarikimin e kontenierëve por edhe të mbetjeve voluminoze kur të jetë e nevojshme; spond anor ose fundor te hapshem per te lejuar ngarkimin e konteniereve si dhe mbulese kur përdoret për grumbullimin e mbetjeve të vëllimshme.

**Kushte të përgjithshme:** Janë të njëjta si dhe për kamionin teknologjik për mbetjet e pariciklueshme.

#### **Automjete rezervë**

Operatori do të vërë në dispozicion të zbatimit të kësaj kontratë edhe mjete të tjera ta cilat do të kërkohet të përdoren në kushtë të vecanta për shkak të aksesit të vështirë rrugor, gjenerimit të mbetjeve mbi normën e llogaritur si dhe rritjen e volumit të mbetjeve vëcanërisht për efekt të rritjes së pritshme të rritjes së numrit të turistëve, duke filluar nga viti i dytë i kontratës, vëcanërisht në Njësinë Administrative të Shëngjinit.

Këto mjete do të jenë me përdorim të përkohshëm ( të llogaritura sa ¼ e kohës së plotë të përdorimit), dhe do të përfshijnë:

#### ***Kamioncinë me kapacitet 1-3 ton:***

**Kapaciteti:** Deri 1-3 ton, i pajisur me ndricim (prozhektor fundor) dhe sinjalizues zanor dhe ndricues, si dhe pasqyra të jashtëmë që sigurojnë shikimin e shoferit në pjesën e mbrapme gjate procesit të lëvisjes mbrapsh dhe ngarkim shkarkimit.

**Qëllimi i përdorimit:** Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve në kushtë të vecanta me akses të vështirë rrugor.

#### **Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve**

Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo ditë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje ose do e kryejë procesin e larjes dhe dezinfektimit ne PGM me mjetet dhe paisjet specifike. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.



Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë, të paktën sa 5 % e numrit të kontenierëve në përdorim për të zëvendësuar çdo ditë kontenierët e tërhequr për tu larë.

Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.

Rekomandohet që të përdoret një sasi sa me e vogël uji dhe solucioni larës.

Ujrat nga larja e kontenierëve duhet të derdhen në sistemin e ujrave të zeza ose në një depozitë e cila siguron trajtimin e tyre paraprakisht derdhjes në natyrë.

Me elementin e dezinfektimit kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane etj.

Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij një depozitë uji si dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve ose të kryeje procesin në PGM me mjetet dhe pajisjet specifike.

Dezinfektimi dhe deratizimi kryhet me dezinfektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit për mirëmbajtjen e kontenierëve duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **Grafiku i larjes së kontenierëve**

Grafiku për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatitet nga Operatori i Shërbimit dhe miratohet çdo vit nga Autoriteti kontratues.

Grafiku i këtij aktiviteti perputhet me grafikun e grumbullimit të mbetjeve duhet të zbatohet rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.

Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre

### **Rregulla për tu zbatuar**

Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj.

Të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit e të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore (Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe) dhe më pas nga Autoriteti Kontratues.

Mos miratimi i lëndëve kimike dhe normës së përdorimit të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

### **Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, Pastrimi dhe Mirembajtja**

Operatori i shërbimit do të mbajë të pastër (pastrojë dhe fshijë me fshesë dore) Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve, nga të gjitha mbetjet të cilat ndodhen jasht kontenierëve ose që bien nga kontenierët gjatë procesit të ngarkimit të mbetjeve në mjet. Pastrimi do të bëhet mbi një sipërfaqen jo më të vogël se **30 m<sup>2</sup>**. PGM do të desnifektohet periodikisht me një përzierje pluhur gëlqere me 5 % klor.

Pastrimi dhe fshirja e PMG-ve do të përmbledhë mbledhjen, pastrimin dhe largimin e mbeturinave të hedhura në dhe përreth PGM-ve dhe pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes së caktuar brenda dhe rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve dhe sistemimi në vëndet e caktuara.

Kontenierët do të vendosen në rrafsh horizontal, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.

Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, Operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Penalitetet dhe Ndalesat”.

Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur larg PGM –ve të miratuara, Operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen e pikave të reja në grafikun e punimeve.

Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e mjeteve dhe punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë nga dhe me koston e Operatorit. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë, Operatori do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

Përdorimi i uniformave dhe i kartave të identifikimit për punonjësit që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

### **Informimi dhe komunikimi**

Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë Komunikimi” për marrjen e ankesave apo kërkesave, e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 10.00-18.00. Përfaqësues të Operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit Kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 48 oreve nga marrja e njoftimit. Operatori duhet të vërë në dispozicion një numër telefoni, i cili do të bëhet publik dhe do të vendoset në Zyren e Komunikimi për t’i krijuar mundësi komunikimi qytetarëve dhe institucioneve.

Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, përfshi këtu

familjarë, biznese apo institucione, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin Kontrates.

### **Vendi i depozitimit të mbetjeve**

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit. Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazën e cimin njësi aktual të depozitimit në landfill-in e Bushatit dhe sasisë së mbetjeve të pariciklueshme të vleresuara nga Autoriteti Kontraktues.

### **Personeli Kryesor**

Përvec sa është specifikuar në Shtojcën përkatëse për kërkesat e personelit, të dhëna të tjera specifike janë paraqitur sa më poshtë:

#### **Drejtuesi teknik (DT)**

DT duhet të ketë arsim të lartë, i diplomuar në një nga fushat sipas kuadrit ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë për mbrojtjen e mjedisit dhe sic është specifikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

#### **Përgjegjesi teknik (PT)**

PT duhet të ketë minimumi arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional në fushat teknike. Avantazh do të jetë arsimi i lartë.

#### **Punojësit e tjere**

Shoferët/drejtuesit e mjeteve duhet të jenë të pajisur me patentë sipas përcaktimeve të kodit Rrugor referuar mjetit që drejton;

Shoferët/drejtuesit e mjeteve, duhet të kenë një eksperience pune me mjete të ngjashme ose të të njëjtit kapacitet .

#### **Rritja e kapaciteteve të personelit**

Operatori do të punojë dhe trajnojë personelin e kualifikuar dhe atë punëtor periodikisht për rritjen e kapaciteteve mbi rëndësinë e mbajtjes paster të mjedisit, ndarjen e mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar, reduktimin e mbetjeve, sigurinë në punë, mirëmbajtjen e mjeteve dhe paisjeve, kryerjen e proceseve të punës me cilësi dhe korrektësi dhe tema të tjera që lidhen me objektin e kësaj kontrate.

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

## Shtojca 11

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, NE TERRITORIN E BASHKISE LEZHE”**

**LOTI I- re, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 1, BASHKIA LEZHE”**

#### PREVENTIV

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera për një vit	Vlera per 5 vite
1	Grumbullim, Transport, Larje, Mirembajtje dhe Dezinfektim	Ton/vit	7,534			
2	Grumbullim, Transport, Larje, Mirembajtje dhe Dezinfektim (Zona Turistike ne Shengjin 150 dite, Maj-Tetor)	Ton/vit	5,250			
2	Depozitimi ne Landfillin e Bushat	Ton/vit	12,784			
				<b>Totali pa TVSH</b>		
				<b>TVSH 20%</b>		
				<b>Totali me TVSH</b>		

Afatet e ekzekutimit: 5 vite kalendarike ose 60 muaj nga data e lidhjes se kontrates.

**LOTI II-te, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 2, BASHKIA LEZHE”**

**PREVENTIV**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera për një vit</b>	<b>Vlera per 5 vite</b>
<b>1</b>	Grumbullim, Transport, Larje, Mirembajtje dhe Dezinfektim	Ton/vit	4,133			
<b>2</b>	Depozitimi ne Landfillin e Bushat	Ton/vit	4,133			
	<b>Totali pa TVSH</b>					
	<b>TVSH 20%</b>					
	<b>Totali me TVSH</b>					

Afatet e ekzekutimit: 5 vite kalendarike ose 60 muaj nga data e lidhjes se kontrates.

**LOTI III- te, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT  
TE MBETJEVE URBANE, ZONA 3, BASHKIA LEZHE”**

**PREVENTIV**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera për një vit</b>	<b>Vlera per 5 vite</b>
<b>1</b>	Grumbullim, Transport, Larje, Mirembajtje dhe Dezinfektim	Ton/vit	3,444			
<b>2</b>	Depozitimi ne Landfillin e Bushat	Ton/vit	3,444			
				<b>Totali pa TVSH</b>		
				<b>TVSH 20%</b>		
				<b>Totali me TVSH</b>		

Afatet e ekzekutimit: 5 vite kalendarike ose 60 muaj nga data e lidhjes se kontrates.

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

## **TERMAT E REFERENCËS**

### **LOTI I-re, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 1, BASHKIA LEZHE”.**

#### **Kuptimi i termave**

Termtat e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termtat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe ligjin nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, etj

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimit:**

Qëllimi i këtij shërbimi është menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në territorin e Zonës së I-rë të shërbimit, në një standard dhe cilësi siç përcaktohet në këto Terma Reference dhe të shpërndarë ose me mbulim sic tregohet në hartat pjesë integrale e këtij dokumenti.

Ky shërbim përfshin:

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane
2. Depozitimin për trajtimin perfundimtar te mbetjeve (1) në landfill-in e Bushatit;
3. Pastrimi dhe mirembajtjen e PGM në mënyrën dhe sipërfaqen sic është përcaktuar në Specifikimet Teknike,
4. Mirembajtjen, larjen dhe desinfektimin e kontenierëve në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar në Specifikimet Teknike (Shtojca 9) dhe në paragafët që vijojnë në këtë dokument.

#### **Popullsia në Zonën e Shërbimit**

Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës I - rë të shërbimit është vlerësuar rreth 29,489 banorë (e llogaritur për vitin 2020) në periudhën Tetor – Prill, e cila shtohet me rreth 35,000 persona për çdo ditë në sezonin turistik Maj – Shtator, veçanërisht në zonën e Shëngjinit. Numri i popullsisë që do të marrin shërbim në këtë Zonë në vitin 2021 është vlerësuar ne rreth 29 489 banorë rezidentë (pa përfshirë këtu popullsinë vizitore (turistët). Ndërsa llogaritja për periudhën e sezonit turistik është bërë më vete, duke llogaritur kohë shërbimi prej 5 muaj (150 ditë)

Popullsia që do të shërbehet në periudhën 2020 eshte llogaritur në 29,785 banorë, duke përfshirë të gjitha lagjet e qytetit Lezhë si dhe të gjitha fshtrat e Njësisë Adminsitrative Shëngjin të cilët do të marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimmi të mbetjeve. Popullsia në NJA Shëngjin shtohet me rreth 35 000 banorë në ditë në periudhën e zezonit turistik nga Maji derin në Shtator të cdo viti.



Projeksioni i rritjes së popullsisë sipas zonave të shërbimit

Zona mbetjeve	2020	2021	2,022	2023	2,024	2025
zona 1	29,489	30,682	31,602	32,550	33,527	34,532
zona 2	26,272	27,060	27,872	28,708	29,569	30,456
zona 3	23,588	24,296	25,025	25,775	26,549	27,345
<b>Totali</b>	79,648	82,037	84,499	87,034	89,645	92,334

Mbi bazën e shtimit të popullsisë si dhe të një rritje të gjenerimit të mbetjeve prej 3% në vit për çdo vit të planit, në tabelën që vijon është paraqitur llogaritja e gjenerimit të mbetjeve për periudhën kohore të planit duke marrë si vit bazë të dhënat e vlerësuara për vitin 2019.

		2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona 1	Lezhë-Shëngjin	7,534	7,557	7,580	7,602	7,625	7,648

### Detyrat e Operatorit:

#### Grumbullimi i Mbetejve Urbane

Autoriteti Kontraktor i përcakton Operatorit mënyrën e grumbullimit, transportit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve në përputhje me Ligjin nr.10,463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në kuadër dhe për qëllimin e kësaj kontrate, Operatori do të kryej:

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në landfill-in e Bushatit, në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar në më poshtë në këtë dokument.
2. Pastrimin dhe mirembajtjen e PGM në mënyrën dhe sipërfaqen sic është specifikuar në më poshtë në këtë dokument dhe në Specifikimet Teknike si pjesë e aktiviteteve 1 dhe 2 më sipër,
3. Mirembajtjen, larjen dhe desinfektimin e kontenierëve në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar më poshtë në këtë dokument dhe në Specifikimet Teknike. Këto detyra do të kenë ngarkesë pune të ndryshme në periudha të ndryshme të vitit. Volumi i punës do të shtohet gjatë Sezonit Turistik Maj Shtator dhe do të reduktohet gjatë periudhës jashtë Sezonit Turistik Tetor Prill.

#### Sasia e mbetjeve dhe volumi i punës

Sasia e mbetjeve që do të grumbullohen, transportohen nga Operatori është vlerësuar në shumën prej **12 784 ton/vit**, sipas vlerësimit për vitin e parë të shërbimit. Kjo sasi përfaqëson vlerësimin për sasinë akumulative zona 1 a cila disagregohet në sasinë prej **7 734 ton/vit** dhe shtesën prej **5 250 ton/vit** në periudhën Maj Shtator (150 dite) sezoni turistik, sasi dhe kosto e llogaritur si zone me vete (Zona 4) kryesisht në NJA Shëngjin, që i bashkëngjitet zones 1.

Projeksioni i sasisë së mbetjeve për periudhën 2021 – 2025 i llogaritur mbi bazën e koeficientit të rritjes së popullsisë prej 0.3 % /vit dhe rritjes së gjenerimit të mbetjeve prej 1.3 % / vit dhe koeficientëve të llogaritur të popullsisë rezidente urbane prej 0.7 kg/banor/ditë dhe për popullsinë rezidente rurale në sasisë prej 0,44 kg/banor/ditë e cila përfshin dhe sasinë kg/banor/ditë që gjenerohet nga bizneset dhe institucionet në zonë.

Pavarësisht parashikimeve, sasia e mbetjeve që grumbullohen, transportohen dhe trajtohen nga Operatori do të jetë subjekt i matjes, peshimit dhe pagesat për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit do të bëhen kundrejt sasisë mujore të peshuar, mbi bazën e faturave të peshimit të raportuar nga Operatori dhe të konfirmuar nga Supervizori i bashkisë.

Mbajtja dhe raportimi të dhënave nga Operatori do të respektojnë kërkesat e Nenit 55 të ligjit 10,463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

### Shpërndarja dhe vendi i kryerjes së shërbimit

Përveçse sic është parashtruar, të dhënat në vijim janë pjesë dhe plotësojnë Termat e References dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për të detajuar shpërndarjen e shërbimit në Zonën e I-rë të bashkisë Lezhë.

Nëpërmjet kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues synon të mbulojë me shërbim 100 % të popullsisë që jeton në territorin që përfshihet në Zonën I të shërbimit.

### Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve dhe Kontenierët

ZONA 1	PIKA EGZISTUESE	KONTENIER EGZISTUES	PIKA PER TE SHTUAR	KONTENIER PER TE SHTUAR	PIKA TOTAL	KONTENIER TOTAL
	128	285	15	88	143	373

Duke u nisur nga kjo premisë, ndarja e kontenierëve për zonën 1 është si më poshtë:

- 285 kontenierë për mbetje te përziera funksionale gjatë gjithë vitit,
- 185 kontenierë shtesë për mbetjet te përziera që funksionojnë gjatë sezonit turistik maj-Shtator.

Të gjithë këta kontenierë do të shpërndahen në **143 PGM** sipas itinerareve.

- 36 PGM në zonën e Shëngjinit gjatë me gjithsej 95 kontenierë që do mblidhen me dy turne në stinën e verës;
- 107 PGM për grumbullimin e mbetjeve gjatë gjithë vitit;

### Frekuenca e grumbullimit Zona I

#### Percaktimi I itinerareve

Për të patur një efektivitet sa më të madh të mbledhjes së mbetjeve urbane, janë përcaktuar dy itinerare kryesore gjatë periudhës së dimrit, dhe tre itinerare me frekuencë të shtuar gjatë stinës së verës, kur edhe kemi frekuentim të lartë turistik. Këto itinerare nuk janë definitive, dhe do

të jenë supervizorët e shërbimit së bashku me operatorin që do të kryejë shërbimin që do të përcaktojnë grafikun e saktë të punës, për cdo periudhë raportimi.

Itinerari 1 (dimër) – Rana e Hedhun, Kune, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, SMT, Lalm i ri 3 herë në javë

Itinerari 2 (dimër) – Shëngjin qendër, Sakë, Rruga Shëngjinit, Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg. 7 herë në javë

Itinerari 3 (verë) – Ishull Shëngjin, Ishull Lezhë, SMT, Lalm I ri, 7 herë në javë

Itinerari 4 (verë) – Bul. Nënë Tereza, Rana e Hedhun, Shëngjin Port, Bul. Uillon, Sakë, Kune. 14 herë në javë.

Itinerari 5 (verë) - Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg. 7 herë në javë

### Periudha Jashtë Sezonit Turistik

Gjatë periudhës jashtë sezonit turistik (tetor – prill) do të angazhohen tre mjete; respektivisht 2 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziara , kamiona vetëshkarkues 6 deri 10t, ose 1 mjet me dy turne. Sidoqoftë rekomandohet që kompani të disponojë 2 mjete për këtë periudhë të vitit, si dhe një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 1 – Rana e Hedhun, Kune, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, SMT, Lalm i Ri	1							
Itinerari 2 – Shëngjin qendër, Sakë, Rruga Shëngjinit, Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg.	2							

### Periudha gjatë Sezonit Turistik

Gjatë periudhës së frekuentimit të lartë turistik (maj – tetor) do të angazhohen katër mjete; respektivisht 3 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziara, kamiona vetëshkarkues 10t, që punojnë me dy turne. Sidoqoftë rekomandohet që kompani të disponojë të paktën 4 mjete teknologjike për këtë periudhë të vitit, si dhe të paktën një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 3 – Ishull Shëngjin, Autostrade, Ishull Lezhë, SMT, Lalm i ri	1							
Itinerari 4 – Bul. Nënë Tereza, Rana e Hedhun, Shëngjin Port, Bul. Uillon, Sakë, Kune.	2 & 3							
Itinerari 5 - Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg.	4							

Cdo PGM do të ketë të paktën 1 kontenierë. Lloji dhe specifikimet teknike për kontenierët janë detajuar në Specifikime Teknike (Shtojcen 9) pjese e dokumentave të tenderit.

Operatori dhe Autoriteti Kontraktues mund të rishikojnë numrin, shpërndarjen e Pikave të Grumbullimit të Mbetjve dhe numrin e kontenierëve kur e shikojnë të nevojshme, për të përmirësuar efektivitetin e organizimit të shërbimit dhe optimizimin e kostove.

Tabela në vijim paraqet një pasqyrë të detajuar të numrit të PGM-ve dhe kompozimit të tyre, si dhe numrit të kontenierëve sipas vendndodhjes, PGM-ve, destinacionit të përdorimit, si dhe sezonit.

Theksojme se Autoriteti Kontraktues mund të shtojnë ose heqin apo te ndryshojnë vendosjen e PGM-ve në përputhje me ekzigjencat e ushtrimit të këtij shërbimit gjatë zbatimit të kontratës.

## Personeli

### Personeli i Operatorit

Për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate, Operatori do të angzhohë minimalisht personelin si më poshtë është përcaktuar:

Nr. Rendor	Profesioni	Numri i punonjesve	Detyrat
<b>I. Personel Kryesor</b>			
1	Drejtori Teknik	1	Përgjegjës ligjor për zbatimin e kontratës, i pranuar nga Autoriteti Kontraktor
2	Përgjegjës Teknik	1	I autorizuar nga Drejtori Teknik ose Administratori i shoqërisë për kontrollin e përditshëm të shërbimit
<b>II. Personel me eksperience dhe kushte specifike profesionale</b>			
1	Shoferë	5	Grumbullim, transporti i mbetjeve, Transporti i kontenierëve për larje dhe rivendosje
2	Manovrator	1	
<b>III. Puntorë</b>			
2	Puntorë	12	Ngarkim, shkarkim i kontenierëve, pastrimi i Pikave të Grumbullimit të Mbetjeve, Pikave të Hedhjes së Mbetjeve, Larjen e Kontenierëve etj

**Tabela 1: Personeli i kërkuar për realizimin e kontratës**

- Cdo skuadër për grumbullimin e mbetjeve do të përbëhet nga 1 shofer dhe 2 puntorë;
- Skuadra për ngarkimin dhe transportin dhe larjen e kontenierëve do të përbëhet minimalisht nga 1 shofer dhe 2 puntor.
- Operatori do të ketë në dispozicion 1 shofer për përdorimin e mejtit të vogël vetshkarkues 1-3 ton i cili do të jetë i gatshëm të zëvendësojë shoferët e angazhuar në ciklin e grumbullimit të mbetjeve, transportin e kontenierëve për rastet e tejkalimit të orëve zyrtare të punës dhe raste të tjera kur të kërkohe në kushte të vecanta.

Kapacitetet profesionale të personelit drejtues dhe punonjesve të tjerë, janë përcaktuar në Specifikimet Teknike (shotjca 9).

- Kushtet e punësimit duhet të jenë në përputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionet e tjera të cilat janë aktualisht në fuqi në Shqipëri. Operatori është përgjegjës për të marrë të gjitha masat për parandalimin e aksidentëve dhe sëmundjeve në punë dhe për arsye të punës.
- Personeli i operatorit duhet të jetë i pajisur me doreza dhe rroba pune të përshtatshme, me shenja dalluese të kompanisë dhe sinjalistikë të përshtatshme për sigurinë në punë gjatë natës.
- Grupi monitorues i Bashkisë është përgjegjës për të dhënë udhëzime Drejtorit Teknik dhe Përgjegjësit Teknik të personelit të operatorit.

## Dokumentat standarde të tenderit

- Operatori është përgjegjës për trajnimin dhe edukimin e personelit të tij në mënyrë që të përdorë praktikën më të mirë të punës për grumbullimin e mbetjeve, nxitjen e ndarjes së mbetjeve në burim dhe riciklimin. Kjo përfshin gjithashtu ndalimin e hedhjes së mbetjeve në sistemin e mbledhjes dhe kullimit të ujerave të zeza dhe të shiut si dhe rrjedhat ujore sipërfaqësore, shmangien e pastrimit të vendit të kontenierëve dhe mungesën e kujdesit për dëmtimin apo mirëmbajtjen e kontenierëve.

### **Pagesa**

Pagesa për mbledhjen e mbetjeve, transporti dhe depozitimi në destinacionet e caktuara do të bazohen në sasinë e mbetjeve në ton të mbledhur dhe transportuar çdo ditë dhe e peshuar.

Operatori do të peshojë mbetjet në landfill (ose një peshore tjetër kur në landfill nuk ka një të tillë, që do të pranohet nga Autoriteti Kontraktues) .

Sasitë e peshuara do të raportohen nga Përgjegjësi Teknik i Operatorit dhe operatori që administron peshoren, si dhe do të certifikohen mbikëqyrësi/supervizori përfaqësues i Autoritetit Kontraktues. Raporti i sasive të peshuara dhe të certifikuara si me sipër do të përbëjë bazën për pagesat mujore të Autoritetit Kontraktues për Operatorin.

Supervizori i kontratës i caktuar nga Autoriteti Kontraktues do të kryej sondazhe javore për të certifikuar sasinë e mbetjeve që grumbullohen, transportohen dhe depozitohen në destinacionet respektive.

Pagesa për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve do të përfshijë mbulimin e shpenzimeve të pranueshme të materialeve përkatëse dhe punës së kushtuar për pastrimin dhe dezinfektimin e PGM ku vendosen kontenierët e mbetjeve (sipërfaqen e vendit të pikave të grumbullimit)

Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve është një aktivitet i vecantë dhe subjekt i një pagese të vecantë nga grumbullimi dhe transporti i mbetjeve.

Situacioni mujor i Operatorit do të shoqërohet me flete peshorë të landfill-it për të gjitha mbetjet që transportohen dhe depozitohen për trajtim në landfill.

### **Lejet dhe licensat**

Në zbatim të neneve 57 në 59 të ligjit 10 463 datë 22.9.2011 “Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Operatori do të jetë i pajisur me një licencë të vlefshme nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullimin, transportimin, tregtimin dhe ose duke vepruar si agjent marketingu për mbetjet, të cilat përfshijnë:

a) - Licensën me kod: III.2.B, që të mbulojnë aktivitetin “Pastrim, grumbullim, transportim i mbetjeve urbane deri në vend depozitimit finale”, ku të jenë të përfshira kodet specifike të mbetjeve në përputhje me *Katalogun Shqiptar të Mbetjeve miratuar me VKM nr.99 datë 18.02.2005*).

Kodet .20.03.01      20.03.02      20.03.03      20.03.99 etj

b) Leje mjedisi e tipit ose B së bashku me akt miratimin përkatës për " (te ketë të përfshirë Kodet për mbetjet urbane të Katalogut Shqiptar të Mbetjeve miratuar me VKM nr.99 datë

## Dokumentat standarde të tenderit

18.02.2005), konkretisht ID 5.6 /a ,qe perfshin veprimtarinper larjen e kontenjereve ne menyre qe te riperdoren .

c) License me kodin: II.8.B "Shërbime ndërhyrese higjeno-shëndetësore (Deratizim, dezinfektim, dezinsektim DDD)".

d) Akt-Miratim higjeno-sanitare (e vlefshme), të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH).

Licencat për veprimtaritë e parashikuara në ligjin 10,463, datë 22-09-2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Raportet dhe Statistikat**

Operatori duhet të mbajë statistika të përditshme mbi pikat kryesore të mëposhtme dhe të raportojë supervizorit çdo muaj, në format zyrtar letër dhe në formë dixhitale:

1. numri i kontenierëve të ngarkuar në çdo rrugë
2. orët reale të mbledhjes: ora e nisjes së kamionëve, koha e shkarkimit në landfill, koha e kthimit në garazh/parkim
3. sasinë e mbetjeve që grumbullohet dhe që transportohen në landfill,
4. km rrugë që përshkohen çdo ditë nga çdo kamion për grumbullimin e mbetjeve
5. konsumi i naftës dhe i vajit për çdo kamion, operacionet e mirëmbajtjes dhe data
6. numri dhe itinerari i rrugëve që ndjekin kamionët
7. lista e të punësuarve dhe orëve të punës
8. inventari mujor i kontenierëve, rrugë për rrugë, me numër identifikimi dhe gjendjen fizike
9. zhvendosjen, mirëmbajtjen ose zhdukjen e kontenierëve, larjen e tyre: lista e kontenierëve (rruge, numri i identifikimit), riparime specifike dhe data
10. Informacion mbi kërkesën e të dërguarit të bashkisë ose supervizorit për mangësinë në cilësi ose sasinë e shërbimit;

Në raportin mujor, Operatori i propozon supervizorit ndryshime për miratimin paraparak:

11. Propozon shtimin e kontenierëve nëse është e nevojshme
12. Propozon reduktimin dhe zhvendosjen e kontenierëve nëse është e nevojshme
13. Propozon për shtimin e pikave të reja të mbledhjes
14. Propozon të gjitha mundësitë e përmasimit të shërbimeve, ndryshime të itinerareve, rikuperimin e mbetjeve të riciklueshme, etj.

### **Monitorimi i Performancës**

#### **Monitorimi i Performancës së Operatorit nga Autoriteti Kontraktues**

Ekipi monitorues i bashkisë kryesohet nga Drejtori i Shërbimeve Publike Infrastruktura Transportit dhe Mjedist dhe i përberë nga Pergjegjesi i sektorit dhe specialist të caktuar të Drejtorisë si dhe Mbikëqyrësi/Supervizori (që mund të përfshijë gjithashtu edhe të deleguar nga

## Dokumentat standarde të tenderit

lagjet apo njësitë administrative) si dhe administratoret e Njesive administrative . të Bashkisë do të jenë përgjegjës për monitorimin e cilësisë dhe sasisë së shërbimit.

Organizimi dhe detyrat e ekipit monitorues do të jene si me poshtë:

### **Bashkia**

1. Miraton prioritetet, zhvillon politikat dhe planin e menaxhimit te mbetjeve,
2. Miraton buxhetin dhe tarifat e shërbimeve, duke përfshirë dhe penalitete dhe gjobat,
3. Negocion me operatorin e shërbimit në rast mosmarrëveshje.

### **Drejtoria e Shërbimeve Publike**

1. Përcakton prioritet, zhvillon politikat dhe planin e menaxhimit te mbetjeve,
2. Harton buxhetin, propozon tarifat e shërbimeve, duke përfshirë dhe dënimet,
3. Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimeve: mos mbledhjen e kontenierëve, vendet e grumbullimit te pa pastruara, kontenierët e dëmtuar etj.,
4. Verifikon dhe përshtat shpërndarjen e kontenierëve:
  - a. Kur ka shume kontenierë (që janë bosh): propozon për ti reduktuar apo rishpërndarë ato sipas kërkesës,
  - b. Kur kontenierët nuk janë të mjaftueshëm (ata janë plot dhe ka mbetje ne rruge): propozon rritjen e numrit te tyre.
  - c. Propozon te zhvendose ose te shtoje pikat e mbledhjes
5. Identifikon nevojat e veçanta: mbetjet voluminoze e të tjera dhe i bën propozimet përgjegjësit te Operatorit për të kryer veprimet e duhura ne kohe dhe me cilësi,
6. Jep informacion:
  - a. Përgjegjësit e operatorit, në lidhje me cilësinë dhe sasinë e monitoruar të shërbimit, ne lidhje me:
    - mos mbledhja e kontenierëve ( pozicioni i kontenierëve, rrugët, dita dhe ora e vëzhgimit
    - kontenierët e dëmtuar (pozicioni i kontenierëve, rruga, lloji i dëmtimit, dita dhe orët e vëzhgimit)
    - kontenierët qe nuk lahen çdo muaj,
    - Supervizorit, çdo muaj, sintheza e mungesës së cilësisë:
    - raport mujor, si baze e raportit te bashkisë, penalitetet dhe gjobat e mundeshme.

### **Supervizori/Mbikëqyrësi**

**Roli:** Të kontrollojë respektimin e kontratës, verifikimin dhe certifikimin e faturave dhe propozimin e pagesave te operatorit si dhe gjobat dhe penalitetet kur cilësia dhe sasia e punës nuk janë në termat e përcaktuara në kontratë.

1. Punon ne zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorit të Shërbimit dhe përgjegjësit te sektorit .
  - a. Përcakton prioritet dhe bën porosi për nevojat e veçanta që duhet të kryhen nga operatori (inerte, evente, zhvendosje të kazanëve,...) në kuadër të buxhetit.
2. Harton statistikat dhe kontrollet e sasive,



## Dokumentat standarde të tenderit

- a. Verifikon dhe raporton të dhënat e operatorit (mirëmbajtja e kontenierëve, oraret e grumbullimit, rrugët, km, punonjësit, etj.)
- b. Të dhënat nga administratoret e njësive administrative dhe nga kontrollori që ndodhet në landfill.
3. Harton raporte të përjavshme dhe të përmuajshme për bashkinë, duke u bazuar tek te dhenat nga njesite administrative, dhe statistikat. Raportet do të përmbajnë por nuk do te kufizohen në informacionin si më poshtë:
  - a. Sasitë e shërbimeve: kontrollin dhe miratimin e faturave
  - b. Mungesa e cilësisë: mos mbledhja e kontenierëve, vendet e grumbullimit te pa pastruara, kazanët e dëmtuar, mbetjet e depozituara jashtë vend-depozitimit
  - c. I bën propozime bashkisë për gjobat, kur është e nevojshme, duke u bazuar ne kontratën, raportet e njësive administrative/lagjeve dhe statistikat e mbledhura.
4. Vendors reduktimin ose zhvendosjen e kanonierave dhe propozon rritje të numrit, nëse është e nevojshme
5. Harton propozime për shpenzime të veçanta, dhe ndihmon në përgatitjen e buxhetit vjetor për Bashkinë
  - a. Shpenzime të veçanta jashtë buxhetit (inerte, pika të hapura,...)
  - b. Blerjen e kontenierëve të rinj
  - c. Modifikimin e buxhetit vjetor

### **Kontrollori i vendit te hedhjes se mbetjeve**

**Roli:** kontrolli dhe raportimi i aktiviteteve mbi vendin e hedhjes së mbetjeve.

1. Varet direkt nga bashkia(Drejtori Teknik i Shërbimit të Menaxhimit te Mbetjeve)
2. Kontrollon dhe mbledh informacione të sasisë së shërbimeve, mbetjeve të depozituara në landfill
  - a. Raporte për çdo kamion: Targën e kamionit, ora, shoferi, lloji i mbetjeve (nëse janë të veçanta), pesha;
  - b. Raportet e orëve të punës së kamionit;
  - c. Raportet e çdo ngjarje të veçantë që ndodh në vend: zjarr, aksidente, etj.
3. Kontrollat e cilësisë së mbetjeve
  - a. Informon supervisorin në qofte se sillen mbeturina të palejueshme, shoferë ose kamion të tjerë (të jashtëm...)
4. I jep raport të përjavshëm Supervisorit dhe Drejtori Teknik i Shërbimit të Menaxhimit te Mbetjeve.

### **Penalitetet dhe Ndalesat**

Penalitetet dhe ndalesat janë pjesë e standardit dhe të rregullores për shpërndarjen, grumbullimin e integruar të mbetjeve dhe shërbimin e pastrimit. Ato do të behën pjesë integrale e kontratës për menaxhimin e mbetjeve dhe shërbimin e pastrimit dhe do te miratohen paraprakisht nga këshilli bashkiak si pjese e paktës fiskale dhe vendosjes se tarifave te shërbimit.

## Dokumentat standarde të tenderit

Ekipi monitorues do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve. Elementet kryesore të sistemit të gjobave do të përfshijnë:

### ***Penaliteti për dëmtimin e kontenierëve:***

**Qëllimi:** për të shmangur që kontenierët e dëmtuar të zvogëlojnë efikasitetin e mbledhjes dhe kushtet sanitare të rrugëve në Zonën e shërbimit;

**Përgjegjësia:** Operatori duhet të identifikojë dhe riparojë të gjithë kontenierët e dëmtuar. Operatori duhet të lajë çdo muaj të gjithë kazanët.

**Kontrolli:** I emëruari i bashkisë/supervizori duhet të kontrollojë dhe identifikojë të gjithë kontenierët e dëmtuar dhe të pa larë. Operatori duhet të zëvendësojë kontenierët me një tjetër dhe brenda 5 ditëve duhet ta riparojë kontejnerin e dëmtuar. Ne raportin e tij mujor, operatori do të raportojë tek mbikëqyrësi listën e kontenierëve të dëmtuar ne riparim dhe listën e kontenierëve të larë. Penalitetet e kontraktorit sic janë përcaktuar ne kushtet e përgjithshme te kontrates .

### ***a. Penaliteti për kontenierët e pambledhur***

**Qëllimi:** për të siguruar cilësinë e plotë të mbledhjes, për të detyruar operatorin të ofrojë zgjidhje alternative ne rast të problemeve (mekanike, personale,..)

**Përgjegjësia:** operatori duhet të mbledhë çdo kontenierë në frekuencën e kërkuar

**Kontrolli:** I emëruari/supervizori i Bashkisë do të kontrollojë dhe raportojë operatorit, me informacion të mbikëqyrësit, nëqoftëse mbledhja nuk është bere, duke treguar vendin, numrin, datën dhe orën e vëzhgimit.

Penalitetet e kontraktorit sic janë përcaktuar ne kushtet e përgjithshme te kontrates

### ***Penalitet për depozitimin në vende të gabuara***

**Qëllimi:** për të shmangur në mënyre rigoroze që operatori të depozitojë mbetjet në vendë të gabuara pa një marrëveshje paraprake dhe formale të Bashkisë.

**Përgjegjësia:** operatori duhet të depozitojë mbetjet aty ku i është kërkuar.

**Kontrolli:** Përfaqësuesi i Bashkisë, mbikëqyrësi, ose një zyrtar do të kontrollojë dhe raportojë depozitimin e gabuar.

Penalitetet e kontraktorit sic janë përcaktuar ne kushtet e përgjithshme te kontrates.

### ***Penalitet për mungesën dhe raportimin e gabuar***

**Qëllimi:** për të siguruar që operatori të japë çdo muaj raportimin dhe të dhënat statistikore të kërkuara, dhe që korrespondojnë me realitetin

**Përgjegjësia:** Operatori duhet të japë çdo muaj, në datën 15 të muajt të ardhshëm, të dhënat e kërkuara dhe i raporton supervizorit, të dhënat korrekte dhe reale.

**Kontrolli:** Supervizori do të kontrollojë datën e marrjes së raportit dhe do të kontrollojë vlefshmërinë e të dhënave, me ndihmën e një personi të emëruar nga bashkia dhe kontrollorit në vendin e hedhjes së mbeturinave.

Penalitetet e kontraktorit sic janë përcaktuar ne kushtet e përgjithshme te kontrates

### **Kërkesa për Ofertuesin**

Ofertuesi duhet të demonstrojë sesi ai synon të ofroj shërbimet, si dhe aftësinë e tij teknike dhe profesionale për të garantuar sasinë dhe cilësinë e shërbimit në përputhje me Specifikimet Teknike dhe objektivat e bashkisë.

Ofertat duhet të përmbaj një listë çmimesh për kryerjen e detyrave sic janë parashikuar në keto Terma Reference, dhe dokumentin e Kontratës.

Çmimi i ofertës do të jetë shumatore të gjitha aktiviteteve si me sipas jane detajuar.

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan pune duke përfshirë organizimin, materialet dhe personelin.

Ofertuesi duhet të paraqesë një kontratë ose nënkontratë dhe licence të Drejtuesit Teknik, Përgjegjësit Teknik si dhe kapacitetet e nevojshme teknike (në autoparkun e tij ose një marreveshje me një subjekt të specializuar dhe licensuar) për mirëmbajtjen e kamionëve dhe kontenierëve.

Ofertuesi/Operatori ekonomik duhet të paraqesin kapacitetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës dhe specifikimet e dhëna sic janë përcaktuar në Specifikimet Teknike .

Ofertuesi duhet te siguroje dokumentin që ata kanë, ose që kanë marrë me qira një vend të mjaftueshëm për parkimin, magazinimin, ruajtjen dhe larjen e kamionëve dhe kontenierëve.

Propozimi i ofertuesit duhet të plotësojnë kërkesat teknike, sasiore dhe cilësore të përshkruara në dokumentacionin e prokurimeve dhe gjithshka që kërkohet nga legjislacioni në Republikën e Shqipërisë.

**LOTI II-TE, “SHËRBIMI I PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE, ZONA 2, BASHKIA LEZHE”.**

**TERMAT E REFERENCËS**

**Kuptimi i termave**

Termat e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe ligjin nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, etj

**Objekti dhe qëllimi i shërbimit:**

Qëllimi i këtij shërbimi është menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në territorin e Zonës së II-të të shërbimit, në një standard dhe cilësi siç përcaktohet në këto Terma Reference dhe të shpërndarë ose me mbulim sic tregohet në hartat pjesë integrale e këtij dokumenti.

Ky shërbim përfshin:

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane
2. Depozitimin për trajtimin perfundimtar te mbetjeve në landfill-in e Bushatit;
3. Pastrimi dhe mirembajtjen e PGM në mënyrën dhe sipërfaqen sic është përcaktuar në Specifikimet Teknike,
4. Mirembajtjen, larjen dhe desinfektimin e kontenierëve në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar në Specifikimet Teknike (Shtojca 9) dhe në paragafët që vijojnë në këtë dokument.

### Popullsia në Zonën e Shërbimit

Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës II - të të shërbimit është vlerësuar rreth 22 645 banorë (e llogaritur për vitin 2020)

Popullsia që do të shërbehet në periudhën 2021 është llogaritur në 22 645 banorë, duke përfshirë të gjithë fshtrat e Njësisve Administrative Shenkoll, Zejmen dhe Kolsh, të cilët do të marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimmi të mbetjeve.

Projeksioni i rritjes së popullsisë sipas zonave të shërbimit

Zona mbetjeve	2020	2021	2022	2023	2024	2025
zona 1	29,489	30,682	31,602	32,550	33,527	34,532
zona 2	26,272	27,060	27,872	28,708	29,569	30,456
zona 3	23,588	24,296	25,025	25,775	26,549	27,345
<b>Totali</b>	79,648	82,037	84,499	87,034	89,645	92,334

Mbi bazën e shtimit të popullsisë si dhe të një rritje të gjenerimit të mbetjeve prej 3% në vit për çdo vit të planit, në tabelën që vijon është paraqitur llogaritja e gjenerimit të mbetjeve për periudhën kohore të planit duke marrë si vit bazë të dhënat e vlerësuara për vitin 2019.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona 2	3,306	3,307	3,308	3,309	3,310	3,311

### Detyrat e Operatorit:

#### Grumbullimi i Mbetejve Urbane

Autoriteti Kontraktor i përcakton Operatorit mënyrën e grumbullimit, transportit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve në përputhje me Ligjin nr.10,463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në kuadër dhe për qëllimin e kësaj kontrate, Operatori do të kryej:

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në landfill-in e Bushatit, në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar në më poshtë në këtë dokument.
2. Pastrimin dhe mirembajtjen e PGM në mënyrën dhe sipërfaqen sic është specifikuar në më poshtë në këtë dokument dhe në Specifikimet Teknike si pjesë e aktivitetëve 1 dhe 2 më sipër,
3. Mirembajtjen, larjen dhe desinfektimin e kontenierëve në mënyrën dhe frekuencën sipas grafikut sic janë specifikuar në më poshtë në këtë dokument dhe në Specifikimet Teknike

#### Sasia e mbetejve dhe volumi i punës

Sasia e mbetjeve që do të grumbullohen, transportohen nga Operatori është vlerësuar në shumën prej **4 133 ton/vit**, sipas vlerësimit për vitin e parë të shërbimit.

Projeksioni i sasisë së mbetjeve për periudhën 2021 – 2025 i llogaritur mbi bazën e koeficientit të rritjes së popullsisë prej 0.3 % /vit dhe rritjes së gjenerimit të mbetjeve prej 1.3 % / vit dhe

koeficientëve të llogaritur të popullsisë rezidente rurale prej 0.5 kg/banor/ditë që gjenerohet nga bizneset dhe institucionet në zonë.

**Pavarësisht parashikimeve, sasia e mbetjeve që grumbullohen, transportohen dhe trajtohen nga Operatori do të jetë subjekt i matjes, peshimit dhe pagesat për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit do të bëhen kundrejt sasisë mujore të peshuar, mbi bazën e faturave të peshimit të raportuar nga Operatori dhe të konfirmuar nga Supervizori i bashkisë.**

**Mbajtja dhe raportimi të dhënave nga Operatori do të respektojnë kërkesat e Nenit 55 të ligjit 10,463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.**

### **Shpërndarja dhe vendi i kryerjes së shërbimit**

Përvesce sic është parashtruar, të dhënat në vijim janë pjesë dhe plotësojnë Termat e References dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për të detajuar shpërndarjen e shërbimit në Zonën e II-rë të bashkisë Lezhë.

Nëpërmjet kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues synon të mbulojë me shërbim 100 % të popullsisë që jeton në territorin që përfshihet në Zonën II të shërbimit.

### **Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve dhe Kontenierët**

Operatori që do të ofrojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonë 2 të bashkisë Lezhë (Shënkoll, Zejmen, Kolsh) do të furnizojë dhe vendose në sistem **169 kontenierë** në 114 PGM për gjithë zonën sipas itinerareve të Pikave për Grumbullimin e Mbetjeve siç janë paraqitur në tabelat në vijim dhe hartat shoqëruese Aneksi 2.

	<b>PGM</b>	<b>kosha</b>
<b>Shënkoll</b>	30	41
<b>Tale</b>	24	33
<b>Rrilë</b>	23	34
<b>Zejmen</b>	27	43
<b>Kolsh</b>	10	18
<b>Gjithsej</b>	114	169

- Gjithashtu gjate periudhës së ofrimit të shërbimit do të rishikohet numri, shpërndarja e Pikave të grumbullimit të Mbetjeve dhe numri i kontenierëve kur vlerësohet e nevojshme, për të përmirësuar efektivitetin e organizimit të shërbimit dhe optimizimin 169 kontenierë për mbetje te përziera funksionale gjatë gjithë vitit,

### **Frekuenca e grumbullimit Zona II**

#### **Percaktimi I itinerareve**

Gjatë periudhës së zbatimit të PMIM 2021-2025, është evidentuar se itineraret e nevojshme për të përballuar shërbimin janë 2 dhe rrjedhimisht do të angazhohen dy mjete; respektivisht 2 mjete për

## Dokumentat standarde të tenderit

grumbullimin e mbetjeve të përziara ose të pariciklueshme. Sidoqoftë rekomandohet që kompania të disponojë 2 mjete teknologjike si dhe një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari 1- Autostradë, Rrilë, Tale, Shënkoll

Itinerari 2 – Gajush, Zejmen, Kolsh, Autostradë

Grumbullimi i mbetjeve urbane në **Zonën II** të shërbimit të bashkisë Lezhë do të kryhet në një frekuencë 3 herë jave për 52 jave gjatë gjithë vitit sipas itinerareve si më sipër. Gjatë sezonit turistik, do të jetë e nevojshme të shtohet një itinerar tjetër për mbledhjen e mbetjeve të shkatuara nga frekuentimi I lartë turistik në plazhin e Tales dhe në rrugën hyrëse, me një frekuencë 7 herë në javë. Grafiku i grumbullimit paraqitet si më poshtë vijon:

### Grafiku i grumbullimit të mbetjeve për zonën 2:

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 1- Autostradë, Rrilë, Tale, Shënkoll	I							
Itinerari 2 – Gajush, Zejmen, Kolsh, Autostradë	I							
Itinerari turistik – Tale – Shënkoll – Autostradë	II							

Cdo PGM do të këtë të paktën 1 kontenierë. Lloji dhe specifikimet teknike për kontenierët janë detajuar në Specifikime Teknike, pjese e dokumentave të tenderit.

Operatori dhe Autoriteti Kontraktues mund të rishikojnë numrin, shpërndarjen e Pikave të Grumbullimit të Mbetjeve dhe numrin e kontenierëve kur e shikojnë të nevojshme, për të përmirësuar efektivitetin e organizimit të shërbimit dhe optimizimin e kostove.

Theksojme se Autoriteti Kontraktues mund të shtojnë ose heqin apo te ndryshojnë vendosjen e PGM-ve në përputhje me ekzgjencat e ushtrimit të këtij shërbimit gjatë zbatimit të kontratës.

### Personeli

#### Personeli i Operatorit

Për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate, Operatori do të angzhojë minimalisht personelin si më poshtë është përcaktuar:

Nr. Rendor	Profesioni	Numri i punonjesve	Detyrat
<b>Personel Kryesor</b>			
1	Drejtori Teknik	1	Përgjegjës ligjor për zbatimin e kontratës, i pranuar nga Autoriteti Kontraktor

## Dokumentat standarde të tenderit

2	Përgjegjës Teknik	1	I autorizuar nga Drejtori Teknik ose Administratori i shoqërisë për kontrollin e përditshëm të shërbimit
<b>Personel me eksperience dhe kushte specifike profesionale</b>			
3	Shoferë	3	Grumbullim, transporti i mbetjeve, Transporti i kontenierëve për larje dhe rivendosje
<b>Puntorë</b>			
4	Puntorë	5	Ngarkim, shkarkim i kontenierëve, pastrimi i Pikave të Grumbullimit të Mbetjeve, Pikave të Hedhjes së Mbetjeve, Larjen e Kontenierëve etj

**Tabela 2: Personeli i kërkuar për realizimin e kontratës**

